



QENDRA PER NDRYSHIM  
CHANGE CENTER  
ORGANIZED CITIZENS BRING CHANGE  
AND GOOD GOVERNANCE

Fjalët nuk  
sjellin ndryshim,  
buxhetet po!

# BUXHETIM




VLERESIMI  
I POLITIKAVE/  
PROGRAMEVE  
DHE BUXHETEVE  
VENDORE  
NE KUADER TE  
PRESPEKTIVES  
GJINORE


*Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor mbështetet teknikisht nga:*



*falë mbështetjes financiare të:*



Vlorë, Janar 2016



PËRGATITUR NGA ORGANIZATA:  
"QENDRA PËR NDRYSHIM" - VLORË

# Tabela e përmbajtjes

FALENDERIME.....	4
SHKURTIME.....	6
HYRJE.....	7
QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT.....	9
METODOLOGJIA.....	11
BUXHETIMI I NDJESHËM GJINOR.....	15
Çfarë është Buxheti Gjitor?.....	15
Kush duhet të bëjë Buxhetim Gjitor?.....	17
Pse Buxheti Gjitor fokusohet te gratë?.....	18
KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PER BARAZINE GJITORE.....	19
VLERËSIM I POLITIKAVE GJITORE PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT URBAN, TURIZMIT DHE NDIHMËS EKONOMIKE.....	32
Shërbimi i transportit urban.....	33
Turizmi.....	37
Shërbimi i Ndihmës Ekonomike.....	40
VLERËSIM I BUXHETEVE VENDORE PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT URBAN, TURIZMIT DHE NDIHMËS EKONOMIKE.....	45
GJETJET E STUDIMIT.....	47
REKOMANDIME.....	50
REFERENCA.....	53

# FALENDERIME

Realizimi i këtij studimi është bërë në kuadër të projektit për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinnor në nivel lokal, i zbatuar nga Organizata **“Qendra për Ndryshim”** falë përkrahjes financiare dhe asistencës së **Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjimore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women)**, me zyrë në Tiranë, dhe në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, Bashkinë Sarandë dhe Institucionet Publike Vendore.

Për realizimin e këtij studimi është punuar gjatë një periudhe 3 vjeçare, duke filluar prej viti 2013 deri në vitin 2016 nga përfaqësues të Organizatës, **“Qendra për Ndryshim”** në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarë lokalë të Bashkisë Vlorë, dhe Sarandë, Drejtorinë e Administrimit të Qytetit, Drejtorinë e Shërbimeve, Drejtorinë e Turizmit dhe të Shërbimit Social. Bazuar në eksperiencën e mëparshme të Organizatës tonë në realizimin e projekteve për Buxhetimin me Pjesëmarrje, si dhe falë bashkëpunimit konstruktiv me aktorë lokalë të Shoqërisë Civile dhe Grupe Interesi, u bë e mundur evidentimi i shumë çështjeve prioritare që shqetësojnë qytetarët e bashkive Vlorë dhe Sarandë si dhe u mundësua diskutimi dhe konsultimi me qytetarë në përgjithësi e sidomos me gra e vajza për të ndarë ide, sugjerime, alternative e propozime se si mund të përmirësohen shërbimet aktuale publike të ofruara nga pushteti lokal për grupe të veçanta interesi, pra për gratë dhe vajzat.

Një kontribut shumë të çmuar në realizimin e studimit kanë dhënë, punonjës të administratës publike të Bashkisë Vlorë dhe Sarandë si dhe specialistë të buxhetimit gjinnor të UN Women.

Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon për organizatën e Shoqërisë civile **“JONA”** Saransë për punën e mirë dhe përkushtimin në realizimin e aktiviteteve në Sarandë në të gjitha takimet me qytetarë e grupe interesi si dhe lehtësimin e bashkëpunimit me pushtetin lokal Sarandë.

Falenderojmë gjithashtu qytetarët e Bashkive Vlorë e Sarandë, sidomos gratë dhe vajzat që u treguan të gatshme të ndajnë me ne shqetësimet e tyre, por edhe të paraqesin sugjerime, alternativa dhe ide konkrete se si mund të

përmirësohen shërbimet e ofruara nga Bashkia Vlorë dhe Sarandë për qytetarët në përgjithësi e për gratë dhe vajzat në veçanti.

Dhe padyshim që falenderimi më i madh shkon për Entin e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), me zyrë në Tiranë të cilët mundësuan realizimin e këtij studimi, falë përkushtimit dhe këmbënguljes së tyre për ndryshimin dhe përmirësimin e statusit të grave dhe vajzave në Shqipëri.

Mendimet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim janë tërësisht mendime dhe qëndrime të autorëve dhe ato nuk janë mendime dhe qëndrime të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women).

# SHKURTIME

**BNGJ** – Buxheti i Ndjeshëm Gjinator

**INSTAT** – Instituti i Statistikave të Shqipërisë

**MMSR** – Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

**MPÇSShB** – Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

**OZHM** – Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

**PBA** – Programi i Buxhetit Afatmesëm

**SKBGJ-DHBGJ** – Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjimore dhe Reduktimin e Dhunësme Bazë Gjimore e Dhunës në Familje 2011-2015

**UN Women** – Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjimore dhe Fuqizimin e Grave



# HYRJE

Në Tetor 2013, UN Women nëpërmjet projektit Promovimi i Politikave Gjinore në Europën Juglindore mbështeti Organizatën “Qendra për Ndryshim” në inisiativën e saj “Buxheti Gjinor – sfidë dhe mundësi e pushtetit lokal për përmirësimin e barazisë gjinore”. Nga diskutimet me përfaqësues të Pushtetit Lokal dhe duke u bazuar në scorecards për nevojat e komunitetit, “Qendra për Ndryshim” ka përzgjedhur tre sektorë për t’u analizuar. Këto sektorë janë: transporti urban, zhvillimi i turizmit dhe ndihma ekonomike. Analiza për këto sektorë është bërë për periudhën 2011-2015.

Aktualisht, zyrat e pushtetit lokal në të gjithë Shqipërinë janë në një proces të hartimit të buxhetit vjetor, pasi procesi fillon qysh në gjysmën e dytë të çdo viti dhe përfundon në Dhjetor ose në Janar, pasi përshtatet me ndryshimet e përvitshme që bën pushteti qëndror në lidhje me ndarjen e granteve për secilën Bashki bazuar në disa kriterë që përcaktohen nga pushteti legjislativ shqiptar. Për këtë arsye, ne besojmë se hartimi i këtij raporti vlerësimi është një oportunitet i mirë për Bashkinë për të rritur njohuritë për realizimin praktik të buxhetimit gjinor dhe për të hartuar një buxhet të përgjegjshëm gjinor bazuar në sugjerime, ide, alternative dhe propozime nga qytetarët e bashkive përkatëse e sidomos nga gratë dhe vajzat. Duke qenë se, projekti i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor ka synuar edhe në rritjen e kapaciteteve intelektuale të punonjësve të Bashkive Vlorë e Sarandë si dhe të Këshilltarëve Bashkiak për çështjet e barazisë gjinore me qëllim përfshirjen e prioritetëve të grave dhe vajzave në buxhetin vjetor, është punuar paralelisht me trajnime dhe konsultime me të gjitha grupet e sipërpërmendura për të bërë të mundur që të kemi një qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të hartimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor vit pas viti nga vetë stafi i Bashkive Vlorë dhe Sarandë.

Kryerja e analizave gjinore përbën bazën për integrimin gjinor dhe është e nevojshme për të parë nëse nevojiten aktivitete specifike për burrat dhe gratë përveç aktiviteteve të përbashkëta. Gjithashtu, buxheti gjinor ndihmon në përmbushjen e politikave dhe synimeve strategjike dhe adreson hendekun gjinor në politikat dhe buxhetet vendore.

Analiza në këtë raport vlerësimi është mbështetur në të dhënat dhe informacionet e përftuara si rrjedhojë e përdorimit të metodës së intervistimit, sondazheve, diskutimeve direkte me qytetare, zyrtarë lokale, Këshilltarë, grupe interesi, gra dhe vajza, si dhe përmes analizave të kornizave ligjore në fushën e barazisë gjinore dhe strategjive kombëtare.

Ky raport është organizuar në 6 seksione kryesore që pasojnë këtë hyrje:

Seksioni II përshkruan metodologjinë e përdorur në këtë raport vlerësimi.

Seksioni III sqaron se çfarë kuptohet me buxhetim gjinor dhe kush duhet të bëjë një buxhetim gjinor.

Seksioni IV përshkruan kuadrin ligjor dhe institucional të buxhetimit gjinor për pushtetin vendor.

Në vazhdim, seksioni V analizon politikat dhe programet për tre sektorët e zgjedhur.

Seksioni VI analizon buxhetin e tre shërbimeve të përzgjedhura nga pikëpamja gjinore.

Si rezultat i analizës së situatës, seksioni VII përshkruan gjetjet kryesore të studimit dhe

seksioni VIII përshkruan rekomandimet me më shumë përparësi për Bashkinë për të tre sektorët.



# QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi këtij studimi është analizimi i gjëndjes aktuale, dhe i mundësive për fillimin e zbatimit të një proçesi të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Bashkinë e Vlorës dhe të Sarandës. Studimi trajton analizimin e shërbimeve të ofruara nga organet e qeverisjes vendore, kapacitetet e Bashkive në kuadër të perspektivës gjinore, vullnetin politik të personave që miratojnë vendime në nivel lokal, të çështjeve gjinore, si dhe mundësive reale të Bashkive të sipërpërmendura për realizimin e një analize gjinore, për të mundësuar aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor vit pas viti në mënyrë të pavarur dhe nga vetë zyrtarët local të Bashkive Vlorë dhe Sarandë.

Gjithashtu me anë të këtij studimi, synohet që të analizohet në tërësi cilësia e shërbimeve të ofruara nga Bashkitë Vlorë dhe Sarandë dhe në veçanti, realizimi i shërbimeve të turizmit, transportit dhe ndihmës ekonomike në dobi të qytetarëve në përgjithësi dhe në dobi të grave dhe vajzave në veçanti. Nëpërmjet përfshirjes së zërit qytetar synohet gjithashtu, që të krijohet një model i ri i hartimit të buxhetimit me pjesëmarrje e sidomos duke i dhënë përparësi buxhetimit gjinor, pra përfshirjes së çështjeve dhe problemeve që shqetësojnë gratë dhe vajzat në planet dhe programet e pushtetit lokal e sidomos në përfshirjen e këtyre çështjeve në dokumentin financiar të Bashkisë, buxhetin vjetor.

## **Objektivat e projektit por edhe tëkëtij studimi janë:**

- Identifikimi dhe analizimi i shpërndarjes së buxhetit përsa i takon shërbimeve të ndihmës sociale, turizmit dhe transportit në Bashkinë Vlorë dhe Sarandë në 3 vitet e fundit, duke marrë parasysh balancën gjinore;
- Promovimi dhe forcimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave, në proçesin e buxhetimit me pjesëmarrje;
- Të kontribuojë në fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave dhe vajzave nëpërmjet forcimit të pjesëmarrjes në planet e zhvillimit në Bashkinë e Vlorës dhe Sarandës;
- Forcimi i instrumentit të buxhetimit të bazuar në performancën e zyrtarëve

lokal, me një fokus të qartë në treguesit e rezultateve që lidhen me trajtimin e pabarazisë gjinore;

- Të sigurojë që sistemet e menaxhimit të financave publike të përfshijnë proceset e buxhetimit gjinor dhe partnerët e zhvillimit lidhur me këtë qasje të re;
- Hartimi i rekomandimeve kyçe për hartimin dhe përmirësimin e politikave dhe buxheteve nga pikëpamja gjinore për sektorët e sipërpërmendur por edhe për procesin e buxhetimit në përgjithësi.

# METODOLOGJIA

Objektivi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i politikave, programeve dhe buxheteve vendore nga perspektiva gjinore për tre sektorët: transporti urban, turizmi dhe ndihma ekonomike, për tre vitet e fundit 2013 - 2015. Metodologjia është hartuar duke marrë parasysh objektivat dhe qëllimet e parashtruara më sipër.

## **Metodat dhe teknikat e përdorura janë si më poshtë:**

### **• Përpunimi i të dhënave**

Stafi i projektit ka shqyrtuar programet dhe buxhetet perkatëse për tre shërbimet e përzgjedhura, si dhe strategjitë kombëtare në lidhje me këto shërbime dhe barazinë gjinore. Një vëmendje e veçantë iu kushtua legjislacionit në fuqi në lidhje me buxhetet vendore, shërbimet sociale dhe barazinë gjinore.

### **• Intervista**

Në kuadër të këtij projekti, Qendra për Ndryshim në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë ka realizuar përgjatë një periudhe 5 javore anketime dhe intervista me qytetarë në të gjitha lagjet e qytetit, me ndihmën e vullnetarëve të organizatës. Gjatë plotësimit të pyetësorëve dhe intervistave ka patur një mbulim të gjithë territorit të Bashkisë Vlorë, pa lënë mënjanë institucionet publike. Qytetarët e pyetur kanë qenë të rastësishëm, por është bërë kujdes, që pjesa më e madhe e të intervistuarve të jenë gradhe vajza, të moshave të ndryshme, shtëpiake, të punësuar si dhe studente. Janë pyetur gjithsej 245 qytetarë, 212 prej të cilëve gra dhe vajza dhe 33 burra. Proçesi i intervistimit ka zgjatur pak më tepër se parashikimi për vetë faktin se është dashur që shumë qytetarë të sqarohen për buxhetimin gjinor, pasi është hera e parë që në Bashkinë e Vlorës organizohet buxhetimi i përgjegjshëm gjinor. Në shumicën e rasteve qytetarët janë treguar bashkëpunues dhe me shumë durim gjatë intervistimit, por ka patur edhe raste kur qytetarët nuk kanë bashkëpunuar ose janë treguar indiferentë ndaj intervistuesve.

### • **Pyetësorë.**

Janë intervistuar gjithsej 194 persona nga të cilët 49 burra (25%) dhe 145 gra (75%). Për të zbehur ndikimin që ka numri më i lartë i femrave në rezultatet e përgjithshme, pjesa më e madhe e rezultateve të pyetësorëve janë trajtuar veç për femrat dhe veç për meshkujt. Pyetësorët janë përpiluar në mënyrë të tillë që të merret sa më shumë informacion nga qytetarët në lidhje me gjëndjen aktuale të shërbimeve të transportit publik, ndihmës sociale dhe turizmit si dhe për të shprehur sugjerime dhe ide se si mund të përmirësohen këto shërbime nga Bashkia Vlorë. Gjithashtu një vend të veçantë në pyetësorët e përpiluar për qytetarët e Bashkisë Vlorë, zinte barazia gjinore, buxhetimi gjinor, organizimi i sesioneve në lidhje me buxhetimin gjinor nga Bashkia Vlorë, dhe se sa vëmendje i kushton Bashkia Vlorë shërbimeve përkatëse në funksion të grave dhe vajzave. Gjatë plotësimit të pyetësorëve, në përgjithësi qytetarët kanë shprehur gatishmëri për të bashkëpunuar, megjithëse ka patur edhe nga ata që nuk kanë pranuar ti plotësojnë me pretendimin që kërkesat dhe sugjerimet e tyre nuk merren parasysh nga autoritetet vendore.

Të dhënat e pyetësorëve janë përpunuar në SPSS1. Për analizat e pyetësorëve janë përdorur statistika përshkruese. Për pyetjet e mbyllura janë përdorur teknikat e statistikave përshkruese bazuar në llogaritjet e frekuencës, ndërsa për pyetjet e hapura, SPSS (Statistical Program for Social Sciences – Program Statistikash për Shkencat Shoqërore)

ku të anketuarit japin mendimin e tyre të lirë, janë përdorur llogaritjet e frekuencave për lloje të caktuara përgjigjesh.

### • **Takime me komunitetin**

Në kuadër të projektit janë realizuar gjithsej 16 takime, në 5 rajonet e qytetit të Vlorës, në lagje të ndryshme të qytetit. Takimet janë organizuar në formën e diskutimeve për tre shërbimet që ofron Bashkia Vlorë për qytetarët; Turizmin, Transportin dhe Ndihmën Ekonomike.

Në takimet e organizuara në çdo Rajon, ka patur një interesim mjaft të madh nga banorët e lagjeve, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues nga Institucine të tjera publike. Sigurisht që një ndihmesë të madhe në këtë rast ka luajtur fakti që në takime kanë qenë të pranishëm përfaqësues të lartë të Bashkisë Vlorë, N/kryetari i Bashkisë, Administratorja e qytetit, Kryetarët e Rajoneve si dhe Këshilltarë të Bashkisë.

Përfaqësuesit e pushtetit lokal kanë diskutuar me qytetarët dhe janë angazhuar që të ndihmojnë për përfshirjen e prioriteteve të grave dhe vajzave në buxhetin vjetor të Bashkisë për vitin 2014. Sigurisht që kjo është një përjasje e re e cila synon që të rrisë bashkëpunimin institucional midis qytetarëve dhe zyrtarëve

lokalë, duke sjellë në vëmendje të Bashkisë Vlorë dhe Këshilltarëve të Bashkisë, çështje prioritare shqetësuese për qytetarët në përgjithësi dhe sidomos për gratë dhe vajzat në veçanti.

Gjithashtu, në të gjitha takimet e zhvilluara në rajonet e qytetit, pjesëmarrësit janë ftuar të plotësojnë një pyetësor të përgatitur enkas për të marë mendimin e tyre rreth shërbimeve të transportit, turizmit dhe asistencës sociale.



#### • Takime me përfaqësues të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

Fillimisht janë vendosur kontaktet me Bashkinë Vlorë dhe është nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të projektit. Nëambjentet e sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vlorë është zhvilluar një takim me përfaqësues të drejtorive të Shërbimit Social, Transportit, Turizmit dhe punonjës të tjerë të Bashkisë dhe u është shpjeguar atyre ç'është Buxheti Gjini. Gjatë këtij takimi është diskutuar se si mund ta realizojnë institucionet publike buxhetimin gjini, dhe është plotësuar prej tyre një pyetësor mbi zbatimin e buxhetimit gjini në Bashkinë Vlorë dhe veçanërisht në fushën e transportit, turizmit dhe sektorin e asistencës sociale. Gjithashtu janë organizuar takime me Këshilltarë të Bashkisë Vlorë, kryesisht gratë këshilltare, por edhe burra me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për të votuar pro rekomandimeve që do të bëhen në përfundim të projektit për shërbimet e transportit publik, turizmit dhe ndihmës sociale. Vlen të përmendet fakti se jo vetëm këshilltarët gra por edhe ata burra të kontaktuar, ose që kanë qenë pjesëmarrës në takimet e organizuara, kanë shprehur gatishmëri të plotë për të ndihmuar që rekomandimet dhe sugjerimet qytetare të përfshihen në projekt-buxhetin e vitit 2014.

- **Roadshow.**

Realizimi i disa Roadshoës në të dy Bashkitë, Vlorë dhe Saranë, kanë ndikuar së tepërmi në sensibilizimin e komunitetit dhe të grave dhe vajzave për t'u njohur me nismën dhe për t'u bërë më vonë pjesë e takimeve publike, forumeve publike dhe konsultimeve publike në lagje e rajone ku jetojnë banorët e Bashkive përkatëse. Gjatë këtyre Roadshoës, janë shpërndarë fletëpalosje të projektit, materiale për sensibilizim në lidhje me barazinë gjinore dhe Buxhetimin Gjinor si dhe literaturë në lidhje me këto çështje, ku janë përfshirë gra dhe vajza, burra dhe djem. Ata kanë qenë të interesuar të dijnë mbi projektin si dhe çfarë do të bëjnë realisht institucionet përgjegjëse për t'a përfshirë Buxhetimin Gjinor në axhendën e tyre.

# BUXHETIMI I PERGJEGJSHEM GJINOR

*Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i çdo njësie të qeverisjes vendore dhe qendrore, pasi asnjë lloj politike tjetër nuk do të funksiononte pa të ardhura. Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm për të transformuar vendin dhe për t'a orientuar atë drejt barazisë gjinore, si dhe për fuqizimin e grave dhe vajzave për të qenë edhe ato pjesë e rëndësishme e shoqërisë të cilat mbartin një rol decisiv në zhvillimin ekonomik të vendit.*

## **Çfarë është Buxhetimi Gjinor?**

Në realizimin e politikave dhe alokimit e buxhetit, qeveritë duhet të mendojnë si për gjininë ashtu edhe për seksin. Ato duhet të sigurohen se politikat dhe programet janë në dispozicion dhe financojnë në mënyrë adekuate nevojat biologjike të burrave dhe grave, përfshirë këtu lindjen e fëmijëve për gratë.

Për sa i takon gjinisë, qeveritë duhet të kenë një vizion për llojin e rroleve, përgjegjësive dhe lidhjeve që ato shohin si dhe të Implementojnë, planifikojnë dhe realizojnë politika dhe programe që kanë për qëllim realizimin e këtij objekti.

Një buxhet i përgjegjshëm gjinor është ai buxhet i cili nje strukturën gjinore të një shoqërie dhe alokon para për implementimin e politikave dhe programeve që do të ndryshojnë këtë strukturë në mënyrë që kjo shoqëri të arrijë barazinë gjinore.

Proçesi i Buxhetimit Gjinor konsiston në përcaktimin e objektivave të barazisë, analizën e buxhetit ekzistues, për shembull, një komunë, një institucion, një universitet, një vend apo shtet, të përbërë nga të ardhurat e tyre (p.sh. tatimet, taksat, tarifat) dhe shpenzimet për sa i takon këtyre objektivave të barazisë dhe s'ë fundi ndryshimet me qëllim arritjen e plotë të objektivave të barazisë gjinore.

Buxhetimi Gjinor është një tërësi masash, pjesë e strategjisë së Integritimit Gjinor dhe arritjes së barazisë gjinore.

**Kancelaria Federale e Austrisë e përkufizon atë si:**

*Buxheti Gjnor është instrumenti fiskal i strategjisë së barazisë gjnore dhe integritit gjnor. Buxheti Gjnor është një analizë e fuqishme dhe nje mjet kontrolli që krijon drejtësi gjnore duke ndryshuar politikat dhe menaxhimin financiar.*



# Kush duhet të bëjë Buxhetim Gjinator?

Buxhetimi gjinator së pari i drejtohet organeve qeverisëse megjithatë mund të realizohet dhe të përdoret nga persona jashtë qeverisjes siç janë organizatat jo qeveritare, shoqatat e grave, akademikët, donatorët si dhe nga qytetarët e thjeshtë. Për ata jashtë qeverisjes, buxhetimi gjinator shërben për të inkurajuar transparencën, llogaridhënien si dhe pjesëmarrjen në vendim-marrje. Për të dyja palët buxhetimi gjinator krijon mundësinë për një vendim-marrje më të mirë si dhe për shpërndarjen e prioriteteve dhe burimeve në mënyrë të tillë që të arrihet barazia gjinore.

Politikat dhe buxheti i qeverisë kanë si qëllim të kenë ndikim pak a shumë tek të gjithë, t'i shërbejnë interesit publik si dhe nevojave të çdo personi. Një buxhetim gjinator ideal do të ishte ai që do të fokusohet më tepër tek nevojat e grave dhe vajzave pasi ato janë grupet ekonomikisht më të disavantazuara. Buxhetimi gjinator nuk duhet parë si një buxhet i ndarë në zëra të veçantë për meshkujt dhe femrat, ai nuk përbën një buxhet të veçantë, por ka synimin që përmes të dhënave mbi realitetin gjinator të bëjë një shpërndarje të tillë të shërbimeve prej të cilës të përfitojnë në mënyrë të barabartë meshkujt dhe femrat duke ndihmuar në reduktimin e hendekut gjinator.

Buxhetimi Gjinator siguron informacion i cili mundëson vendim-marrje më të mirë sa i takon politikave dhe prioriteteve të cilat duhen rishikuar dhe shoqërimi me masat e nevojshme për arritjen e objektivit të barazisë gjinore.

Buxhetimi Gjinator tenton të fokusohet më tepër në nevojat e grave dhe vajzave sesa ato të burrave dhe djemve pasi ato zakonisht gjenden në disavantazh ekonomik dhe të formave të tjera.

Megjithatë nevoja për prioritet do të thotë se Buxhetimi Gjinator fokusohet përtej nevojave të grave, në nevojat e njerëzve të varfër, të grupeve të marginalizuara, të njerëzve në zonat rurale, e kështu me rradhë. Megjithë diferencat në nevoja, Buxhetimi Gjinator nuk është thjesht ndarja e buxhetit 50% për burrat dhe 50% për gratë. Një ndarje e tillë duket si e barabartë, por zakonisht nuk është, pasi nevojat e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve mund të jenë të ndryshme. Për shembull, në fushën e shëndetsisë, burrat dhe gratë do të kenë nevojë për

të njëjtat shërbime sa i takon gripit ose sëmundjeve parazitare. Por kur është fjala te shëndeti riprodhues, nevojat e femrave janë shumë më të mëdha se ato të meshkujve.

Iniciativa e B PGj nuk kërkon të krijojë buxhete të ndarë në adresë të grave. Qëllimi kryesor është garancia se çdo pjesë e buxhetit merr parasysh dallimet gjinore.

## **Pse Buxhetimi Gjinor fokusohet te gratë?**

### ***Në të gjithë botën Buxhetimi Gjinor ka tendencë të fokusohet tek gratë sepse:***

- Përafërsisht dy të tretat e njerëzve analfabetë në botë janë gra;
- Në vendet në zhvillim vdekshmëria maternale është shkaku kryesor i vdekjes së femrave në moshë riprodhuese;
- Gratë janë të papërfaqësuara në qeverisje dhe sektorin e biznesit, veçanërisht në pozicione drejtuese;
- Puna 'ekonomike' e grave vazhdon të jetë shumë e ndryshme nga ajo e burrave.
- Gratë janë më pak të përfshira formalisht, mbajnë status më të ulët punësimi dhe vazhdojnë të paguhen më pak se burrat për të njëjtën punë.
- Gratë vazhdojnë të bëjnë shumicën e punëve të papaguara, në kujdesin në familje dhe komunitet.

### ***Përfitimet:***

- o Buxhetimi gjinor sjell një sërë avantazhesh të cilat shkojnë tej realizimit të barazisë gjinore;
- o Buxhetimi gjinor krijon transparencë më të madhe mbi vendimarrjet politike që lidhen me buxhetin;
- o Buxhetimi gjinor krijon lehtësi dhe qëndrueshmëri duke qënë se fondet në dispozicion i përshtaten nevojave reale të grupeve të ndryshme shoqërore;
- o Buxhetimi gjinor është një procedurë përmes së cilës dalin në pah implikimet me diskriminimin gjinor të vendimeve në dukje efektive dhe mundëson një ristrukturim mbi barazinë gjinore të vendimeve;
- o Buxhetimi gjinor është një mundësi për të vënë qëllimet e barazisë gjinore në praktikë, duke përfshirë me kalimin e kohës edhe kufij më të gjerë buxhetor.

# KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR BARAZINË GJINORE

Si rregull kufizimi i buxhetimit gjinor në një analizë gjinore dhe në një barazi gjinore të orientuar duke ngritur kështu buxhete publike realizohet duke i pasqyruar ato edhe në kontekstin përkatës të veprimit politik. Kjo është pasqyruar për shembull në Rezolutën e Parlamentit Europian “Mbi Buxhetimin Gjinor” (P5\_TA(2003)0323) e cila përbën edhe një burim të rëndësishëm ligjor për shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Rezoluta e BE parashikon buxhetimin gjinor si;

*“...Buxheti gjinor është zbatimi i integritetit gjinor në procesin e buxhetimit, kjo do të thotë një vlerësim me bazë gjinore të buxhetit, përfshirjen e një perspektive gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor si dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë që të promovohet barazia gjinore.”*

Gjatë dekadës së fundit janë realizuar një numër i konsiderueshëm takimesh të cilët kanë patur si qëllim transformimin e realitetit në jetën e grave duke u kthyer në burim të rëndësishëm edhe për kuadrin e brendshëm ligjor:

- a.** Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW).
- b.** Konferenca botërore e Vjenës mbi “Të Drejtat e Njeriut”.
- c.** Konferenca ndërkombëtare “Mbi Popullësinë dhe Zhvillimin në Kajro” (ICPD).
- d.** Konferenca e Katërt Botërore mbi Gratë (Pekin 1995).
- e.** Plani I Veprimit të Commonwealth mbi Gjininë dhe Zhvillimin. (1995)
- f.** Të drejtat e barabarta të grave dhe burrave janë të rrënjësura në aktin ligjor më të lartë të Shqipërisë, Kushtetuta e miratuar më 1998.

Neni 18 garanton barazi të grave dhe burrave përpara ligjit.

**g.** Shqipëria ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) më 1993 dhe Protokollin Fakultativ përkatës më 2003. Shqipëria i raporton rregullisht Komitetit të CEDAW-t mbi përparimin e saj në përmbushjen dhe zbatimin e dispozitave të CEDAW-t.

**h.** Legjislacioni dhe politikat për gjininë në Shqipëri pasqyrojnë gjithashtu procesin e vazhdueshëm të vendit drejt futjes dhe integritit në Bashkimin Europian, i nisur zyrtarisht përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit më 2006.

Meqenëse barazia është një nga parimet parësore të BE-së, detyrimet e Shqipërisë për harmonizim gjenden në pesë fushat e politikave të shprehura në Strategjinë e BE-së për barazi mes grave dhe burrave, 2010-2015.

Barazia mes grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës private dhe publike përvijohet më tej në legjislacion, si në ligjin nr.9970 “Për Barazinë gjinore në shoqëri”, i cili ka hyrë në fuqi më 2008.

Synimi i këtij ligji është: a) të sigurojë mbrojtje efektive ndaj diskriminimit të lidhur me gjininë; b) të përcaktojë masat për të garantuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, në mënyrë që të eliminohet diskriminimi i lidhur me gjininë; dhe c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore në të gjitha nivelet për hartimin dhe zbatimin e akteve normative dhe politikave në përkrahje të barazisë gjinore. LBGj-ja parashikon harmonizimin e gjinisë si strategji për arritjen e barazisë gjinore përmes integritit të një pikëpamjeje gjinore në të gjitha proceset ligjëbërëse, politikëbërëse, zbatuese dhe monitoruese. Ligji gjithashtu trajton diskriminimin dhe ngacmimigjinor dhe prezanton masa të përkohshme specifike në pozicionet e vendimmarrjes politike dhepublike (për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të seksit të nënpërfaqësuar) si dhe masa të posaçme në sektorët e arsimit dhe punësimit; punë të papaguar; dhe detyrimin për të mbledhurstatistika gjinore.

Dy ligje të tjera rregullojnë posaçërisht barazinë gjinore në Shqipëri: ligji nr.10221 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i miratuar më 2010, dhe ligji nr. 9669 “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” (LMKDhMF), i miratuar më 2007 (i ndryshuar më 2007 dhe 2010).



Ligji kundërdiskriminimit është përshëndetur ndërkombëtarisht për tërësinë e tij; ai parandalon diskriminimin në sferat politike, ekonomike dhe shoqërore jo vetëm në bazë race, etnie, paaftësie apo feje, por gjithashtu në bazë seksi, gjinie, identiteti gjinor dhe orientimi seksual. LMKDhMF-ja është hartuar në mënyrë të tillë që të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje dhe parashikon reagim të përshtatshëm dhe shërbime për viktimat. Dhuna në familje mund të ndiqet penalisht sipas figures penale të përgjithshme të agresionit në Kodin Penal1. Pjesa VI, e titulluar “Krimet seksuale”, trajton përdhunimin, ndërsa neni 110a ndëshkon qartë trafikimin e qenieve njerëzore. Për më tepër, Kodii Familjes2 si dhe Kodi i Punës3 u referohen specifikisht aspekteve të ndryshme të të drejtave dhe privilegjeve të grave në sferën private, si dhe në jetën ekonomike. Kuadri i politikave për barazinë gjinore i Shqipërisë si një strategji ndërsektoriale , Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe për reduktimin dhe ndalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje 2011-2015 (SKBGj- DhBGj- DhF) përvijon strategjitë dhe mekanizmat strategjikë për të përfshirë barazinë gjinore në politikat publike, me qëllim zvogëlimin e diskriminimit gjinor, si dhe për të parandaluar dhe luftuar dhunën me bazë gjinore.

E ripunuar dhe e përditësuar më 2010 nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta (MPÇSShB), veprimet e ndërmarra në kuadër të kësaj strategjie kanë për qëllim të kontribuojnë drejt arritjes së katër rezultateve strategjike:

- 1. Rezultati strategjik:** Të gjithë qytetarët shqiptarë (gra dhe burra) gëzojnë liri nga dhuna dhe të drejta në praktikë për të marrë përsipër përgjegjësi në shoqëri.
- 2. Rezultati strategjik:** Të gjithë qytetarët shqiptarë (gra dhe burra) kanë veprimtari punësimi, ekonomike, sociale dhe politike të përqasura dhe të përshtatshme me aftësitë dhe përvojat e tyre.
- 3. Rezultati strategjik:** Institucionet shtetërore dhe praktikant mbrojnë të gjithë qytetarët (gra dhe burra) nga dhuna dhe i përkrahin ata për të mundur pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri, pavarësisht gjinisë.
- 4. Rezultati strategjik:** Të gjithë qytetarët shqiptarë (gra dhe burra) kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe politik të Shqipërisë dhe në proceset integruese në BE.

***SKBGj-DhBGj-DhF udhëhiqet nga katër fusha përparësie dhe shoqërohet nga planet e veprimit me ndërhyrje dhe tregues të specifikuar për secilën prej tyre. Fushat e përparësisë janë:***

Forcimi i mekanizmave institucionalë dhe ligjorë (Makineria kombëtare për gjininë). Veprimtaritë kanë për qëllim:

- (i)*** të përmirësojnë Makinerinë kombëtare për gjininë në nivel qendror dhe vendor, për të përmbushur detyrat e tyre siç parashikohet në LBGJ;
- (ii)*** të shqyrtojnë legjislacionin shqiptar për të përcaktuar përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare për barazinë gjinore;
- (iii)*** të rrisin kapacitetet e qeverisë qendrore dhe vendore për të zbatuar dhe monitoruar kuadrin ligjor për barazinë gjinore në Shqipëri.

***Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje. Ky objektiv duhet arritur duke:***

- (i)*** marrë masa që garantojnë akses të plotë të grave në politikë;
- (ii)*** rritur përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në 30% në të gjitha nivelet, përmes masave të posaçme të përkohshme;
- (iii)*** rritur pjesëmarrjen e grave në strukturat paqeruajtëse dhe policore;
- (iv)*** rritur aftësinë e grave si qytetare për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe udhëheqje.

***Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave. Veprimtaritë do të përfshijnë:***

- (i)*** rritjen e pavarësisë ekonomike të grave përmes përmirësimit të aksesit në kredi, programe mbështetëse dhe kujdes social dhe shërbime mbrojtjeje;
- (ii)*** trajnim profesional të grave përmes masave në mbështetje të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës;
- (iii)*** zgjerimin e programeve të punësimit përgjatë dhe vajzat.

***Ulja e dhunës me bazë gjinore. Ky objektiv do të arrihet duke:***

- (i)*** ashpërsuar ndëshkimin e DhBGj-së përmes legjislacionit;
- (ii)*** parandaluar DhBGj-në përmes sensibilizimit publik;
- (iii)*** mbrojtur dhe përkrahur viktimat e dhunës dhe abuzuesit përmes shërbimeve që rehabilitojnë dhe riintegrojnë viktimat;
- (iv)*** ndërtuar kapacitetet e administratës publike në të gjitha nivelet për t'iu përgjigjur DhBGj-së.

Paketa kombëtare e treguesve të harmonizuar gjinorë, e miratuar nga qeveria shqiptare më 2010, është instrumenti zyrtar për monitorimin e progresit në zbatimin e politikës së barazisë gjinore në vend. Raportet kombëtare periodike

për barazinë gjinore dhe situatën e grave në Shqipëri kanë për qëllim të hedhin dritë mbi pyetje që kanë të bëjnë me: nëse dhe në çfarë shkalle qëllimet dhe rezultatet e sipërpërmendura po arrihen.

**Kuadri institucional:** Mekanizmat e barazisë gjinore LBGJ-ja ngarkon Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si autoritetin përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore. Funkcioni kryesor i Ministrisë është të monitorojë zbatimin e ligjeve përkatëse dhe aplikimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe barazisë mes burrave dhe grave. Ministria i përmbush këto funksione me ndihmën e strukturave të specializuara, si Drejtoria për shanse të barabarta dhe politika familjare (DShBPF). Në operim që nga viti 2006, misioni i DShBPF-së është të nxisë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në sferat ekonomike, politike dhe kulturore, dhe të hartojë politika për parandalimin dhe uljen e dhunës me bazë gjinore. DShBPF-ja përbëhet nga dy sektorë:

- o Sektori për barazinë gjinore dhe masat kundër dhunës dhe
- o Sektori për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Detyra për të propozuar politika për barazinë gjinore i takon Këshillit kombëtar për barazinë gjinore. Ky Këshill këshillon qeverinë për t'u dhënë drejtimin politikave shtetërore për harmonizimin e gjinisë dhe barazinë gjinore dhe siguron përfshirjen e gjinisë në të gjitha fushat. Këshilli drejtohet nga Ministri i PÇSSH-së dhe përbëhet nga nëntë zëvendësministra dhe tre anëtarë nga shoqëria civile. Këshilli kombëtar për barazinë gjinore parashikohet, gjithashtu, që të luajë një rol domethënës në promovimin e zbatimit të politikave gjinore, për shembull buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, ngritjen e strukturës së nëpunësit të barazisë gjinore dhe grumbullimin e të dhënave gjinore.

Në nivel parlamentar, Komisioni i punës, çështjeve sociale dhe shëndetësisë është përgjegjës për çështjet e grave dhe familjare, krahas çështjeve të marrëdhënieve të punës, çështjeve sociale, sigurimeve shoqërore dhe Shëndetësisë. Ky komision shqyrton projektligje, ndërmerr nisma ligjore në fushat e ekspertizës së tij dhe

bashkëpunon me MPÇSSH-në në çështjet e barazisë gjinore dhe fëmijëve.

Me hyrjen në fuqi të ligjit **“Për mbrojtjen kundër diskriminimit”**, më 2010 u ngrit Institucioni i Komisionerit. Zyra e Komisionerit merr në shqyrtim ankesa për diskriminim nga individë, grupe individësh ose organizata për çështje si diskriminimi përfshirë gjininë, por dhe identiteti gjinor, shtatzënia, orientimi seksual, statusi familjar ose martesor dhe përgjegjësia prindërore. Parashikohet

gjithashtu që të kryejë hetime, të monitorojë zbatimin e këtij ligji, të vendosë sanksione dhe të ofrojënjë mekanizëm efektiv përmes të cilit qytetarët gra në veçanti mund të ndreqin gamën e gjerë të diskriminimit gjinor mbizotërues.

Nëpunësit e barazisë gjinore në nivel qeverie qendrore (ministri) dhe njësie vendore janë të mandatuar për të udhëhequr përpjekjet për harmonizimin e gjinisë dhe parashikohet që të luajnë rolin e promotorëve dhe monitoruesve të zbatimit të politikave gjinore kombëtare.

Zbatimi i kornizave të barazisë gjinore në nivel vendor: Decentralizimi në Shqipëri Decentralizimi politik në Shqipëri ka filluar më 1992, me miratimin e “Aktit të Qeverisë vendore” dhe mbajtjen e zgjedhjeve vendore.

Zbatimi i vetëqeverisjes vendore, megjithatë, filloi seriozisht vetëm në vitin 1998, kur Shqipëria iu bashkëngjiti “Kartës së vetëqeverisjes vendore” të Këshillit të Europës dhe përfshiu parimet e vetëqeverisjes në Kushtetutë. Kushtetuta përcakton që qeveria vendore bazohet në “parimin e decentralizimit” dhe ushtrohet përmes “parimit të autonomisë vendore”.

Procesi i decentralizimit drejt vetëqeverisjes vendore është udhëhequr nga miratimi i një serë politikash dhe ligjesh, si dhe ngritja e strukturave institucionale si në nivel qendror ashtu dhe vendor.

Më 1999 qeveria krijoi Komitetin kombëtar ndërministror për decentralizimin (KKD), i cili miratoi “Strategjinë kombëtare për decentralizim dhe autonomi vendore”. Kjo u pasua nga zhvillimi i një pakete ligjesh për të orientuar administrimin e vetëqeverisjes. Këtu përfshihen ligji nr.8652/00 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverive vendore” dhe ligji nr.8653/00 “Për ndarjen administrativeterritoriale”.

Me rëndësi është që u zhvilluan edhe ligje dhe struktura për të rregulluar aspektet fiskale të vetëqeverisjes, përfshirë ligjin për pronat e paluajtshme të shtetit, ligjin për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisë vendore, dhe krijimin e Agjencisë për inventarizimin dhe transferimin e pronave publike. Kuadri ligjor krijoi formula për transferimin e fondeve buxhetore qendrore te njësitë e qeverisë vendore (NjQV) dhe i fuqizoi NjQV-të për të përpiluar buxhetet e veta të pavarura.

Reformat fiskale në vitin 2002 panë futjen e taksave të reja vendore, si taksat vendore e biznesit të vogël, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, taksat e pronës dhe një sistem tarifash dhe taksash vendore. Proçesi i decentralizimit ka thjeshtuar gjithashtu fushat e përgjegjësisë së njërive të qeverisë vendore sa i përket dhënies së shërbimeve lokale,

duke i përfshirë autoritetet vendore në çështje të rëndësishme, si zhvillimi lokal, planifikimi urban, infrastruktura, menaxhimi i tokës, uji dhe higjiena publike.

Proçesi i decentralizimit në Shqipëri është konceptuar në terma gjinorë neutral,



d.m.th, ka pasur shumë pak diskutime rreth çështjes sesi decentralizimi mund të prekë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, në mënyrë të ndryshme. Kjo çështje ka filluar të trajtohet vetëm së fundmi përmes kornizave ligjore dhe politike për barazinë gjinore, që nënvizojnë detyrimet e njëjste të qeverisë vendore në sferën e barazisë gjinore.

Këto dokumente ligjore dhe politike kanë krijuar, gjithashtu, detyrimin për NjQV-të që të krijojnë mekanizma institucionalë në mbështetje të zbatimit të politikave për barazinë gjinore në nivel vendor, sipas përvijimit të mëposhtëm.



# KUADRI LIGJOR PER PUSHTETIN LOKAL

Kuadri ligjor dhe politik për barazinë gjinore në nivel vendor Legjislacioni që ka të bëjë me gjininë në Shqipëri krijon detyrime ligjore për qeveritë vendore.

*Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i vitit 2008, për shembull, kërkon nga njësitë e qeverisë vendore që:*

- Të bashkëpunojnë me institucionet e qeverisë qendrore për të zbatuar legjislacionin gjinor dhe politikat kombëtare për barazinë gjinore;
- Të bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse që punojnë brenda territorit të tyre për të arritur barazi gjinore në fusha të ndryshme;
- Të mbledhin dhe të analizojnë të dhëna të ndara sipas seksit;
- Të caktojnë një ose disa nëpunës të barazisë gjinore vendorë për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore;
- Të marrin masa të posaçme të përkohshme e për të rritur përfaqësimin e grave në pozicionet vendimmarrëse (kuota 30%).

*Ligji nr.9669 “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” i detyron autoritetet vendore që:*

- Të angazhohen në ngritjen e strukturave të shërbimeve sociale për rastet e dhunës në familje;
- Të instalojnë linja telefonike rajonale 24-orëshe pa pagesë, për të vendosur lidhje me njësitë vendore, policinë, ekipet e urgjencës mjekësore dhe OJQ-të, për të bashkërenduar kështu veprimet e tyre;
- Të ngrenë qendra sociale dhe rehabilitimi për viktimat dhe dhunuesit dhe të bashkërendojnë përpjekjet me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

*Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe çrrënjosjen e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje (SKBGj-DhBGj-DhF), e ripunuar më 2011, kërkon që njësitë e qeverisë vendore:*

- Të kontribuojnë në zbatimin e strategjisë në nivel vendor dhe të bashkërendojnë punëpërmes nëpunësve të barazisë gjinore (NBGj);
- Të kontribuojnë në përmirësimin e Makinerisë kombëtare të gjinisë përmes caktimit të NBGj-ve në nivel vendor;
- Të japin shërbime të përshtatshme që rehabilitojnë dhe riintegrojnë viktimë/at, mbijetuarin/it e DhBGj-së;
- Të përqëndrohen në ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore për t'iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore.

*Kuadri institucional për barazinë gjinore në nivel vendor: Nëpunësit ebarazisë gjinore*

Neni 13/3 i LBGj-së parashikon caktimin e Nëpunësve të barazisë gjinore (NBGj) në çdo ministri tëlinjës; neni 14 detyron caktimin e NBGj-ve në të gjitha organet e qeverisë vendore. Në parim, këtu përfshihen Bashkitë, Komunat, Prefekturat dhe Qarqet. NBGj-të zëvendësojnë sistemin më joformal të Pikave të kontaktit për gjininë të ngritura në nivel vendor, të cilët shpesh luanin edhe këtë rol krahas detyrave të tyre zyrtare të punës.

# BARAZIA GJINORE DHE QEVERISJA VENDORE

NBGj-të parashikohet që të mbështesin përfshirjen e çështjeve të barazisë gjinore në politika, programe dhe plane, si dhe të monitorojnë zbatimin e angazhimeve të qeverisë qendrore dhe vendore për barazinë gjinore. NBGj-të parashikohet gjithashtu që të luajnë një rol kyç në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, sidomos të dhëna të ndara sipas seksit, dhe në kryerjen e analizave gjinore për të informuar politikëbërjen vendore, dhe në zhvillimin e partneriteteve me aktorë dhe mbështetës të tjerë gjinorë. Disa NBGj luajnë rol edhe në ngritjen e fondeve, pasi fondet e akorduara për nismat gjinore nga ana e NjQV-ve janë shpesh të kufizuara.

Parashikohet gjithashtu që njësitë e qeverisë vendore të punësojnë një specialist të dhunës në familje. Gjithsesi, deri përpara zgjedhjeve vendore në maj 2011, vetëm 14 Bashki (nga 65 të tilla) kishin caktuar NBGj.

Duke pasur parasysh përqindjen e ulët të NBGj-ve në operim, këto dy pozicione: NBGj dhe eksperti i dhunës në familje - shpesh janë shkrirë dhe janë mbuluar nga njëjtë individ për shembull në Bashkitë pilote të mbështetura nga aktorë si projekti “Barazi në qeverisje” dhe organizma të OKB-së. Këta NBGj shpesh njihen si “Nëpunës të barazisë gjinore dhe dhunës në familje” (NBGj/DhF), dhe luajnë një rol kyç në bashkërendimin e reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje në nivel vendor.

Me gjithë larminë e detyrave të ngarkuara NBGj-ve nga ligji dhe nga praktika, kontributet e tyre nuk janë njohur gjithnjë plotësisht nga NjQV-të. Siç do të tregojë dhe ky botim, është me rëndësi të madhe që NBGj-të të emërohen, të zyrtarizohen, të njihen dhe të institucionalizohen në të gjitha nivelet vendore në të gjithë Shqipërinë, në rast se duam që qeverisja vendore e përgjegjshme gjinore të përhapet në mënyrë të qëndrueshme.

Rëndësia e NBGj-ve si strukturë e barazisë gjinore shtjelohet me më shumë hollësi në studim rastin e Kapitullit 5 për Reagimin e koordinuar të komunitetit

ndaj dhunës në familje' në Bashkinë e Gramshit.

Financimi i barazisë gjinore në nivel vendor Kornizat ligjore dhe politike, si dhe strukturat institucionale, kërkojnë në fakt burime për një funksionim efektiv. Zhvillimi i politikave efektive për barazinë gjinore kushton para.

Po ashtu edhezbatimi efektiv i tyre, monitorimi i zbatimit të tyre, dhe sigurimi i orientimit të informuar për t'i përmirësuar ato.

Kur NjV-të angazhohen për të zbatuar programe me lidhje gjinore, apo për të futur procese të përgjegjshme gjinore, ku mund të gjejnë ato burime të përshtatshme?

Aktualisht, ka afërsisht pes ëburime për financimin e programeve, projekteve dhe nismave të përgjithshme të qeverisë vendore,të renditura sipas pikave të mëposhtme.

Në parim, nismat për barazinë gjinore në nivel vendor mund të financohen nëpërmjet këtyre burimeve.

## **Lloji i burimit financiar:**

### **Përshkrimi**

#### **1) Buxheti i qeverisë vendore**

Këtu përfshihen transfertat nga buxheti shtetëror kombëtar("buxheti i kushtëzuar" për funksione të deleguara nga qev eriaqendrore te NjQV-të) si dhe të ardhurat e veta të mbledhura ngataksat dhe tarifat vendore ("buxheti i pavarur").

**2) Financim publik përmes granteve konkurruese** Fondi Rajonal i Zhvillimit përdoret për të financuar në bazë konkurrimi nisma të njëjësive të qeverisë vendore në fushat einfrastrukturës, arsimit, kujdesit shëndetësor , kulturës dhe artit, ujtdhe higjienës publike dhe zhvillimit rural.

#### **3) Financim nga donator dypalësh/shumëpalësh**

Këtu përfshihen programe dypalëshe qeveri-donator, programe tëfinancuara nga organizmat e OKB-së, si UNDP, si dhe instrumentefinancimi të Komisionit European, si 'Instrumenti i asistencës sëPara-Anëtarësimit' (IPA).

#### **4) Partneritetme organizatat jofitimprurëse**

Qeveritë vendore mund të vendosin partneritet me organizatat jofitimprurëse (OJF) në nivel vendor dhe qendror, në mënyrë që të sigurojnë fonde të

kanalizuara direkt tek OJF-të nga donatorët.

### **5) Kredi**

NjQV-të mund të zbatojnë projekte duke negociuar kredi nga burime qeveritare. Burimi: Aksesi te fondet vendore/kombëtare për zbatimin e projekteve të ndjeshme gjinore.



***Atëherë, cilat janë përgjegjësitë e NjQV-ve në lidhje me financimin e barazisë gjinore?***

NjQV-të janë të detyruara të marrin parasysh strategjinë e zhvillimit ekonomik të qeverisë vendore, si dhe strategjitë sektoriale dhe strategjitë ndërsektoriale që përmbajnë përgjegjësi për NjQV-të sa i përket barazisë gjinore (si Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe çrrënjosjen e dhunës me bazë gjinore dhedhunës në familje,

që parashikon përgjegjësitë në nivel NjQV-je). Duke qenë se fondet e posaçme për zbatimin e SKBGj-DhBGj-DhF akordohen vetëm në nivel buxheti kombëtar, NjQV-të përballen me sfidën për të garantuar me iniciativën e tyre që, përgjegjësitë e qeverisë vendore që rrjedhin nga SKBGj-DhBGj-DhF dhe nga politika dhe ligje të tjera kombëtare për barazinë gjinore, të buxhetohen në mënyrë të përshtatshme në buxhetin vendor.

NjQV-të mund të shtrëngohen më tej nga aftësitë e kufizuara lokale për ngritjen e të ardhurave në nivel vendor, sidomos në Bashkitë e varfra dhe me strukturë të dobët.

Bashkitë që kanë kaluar trazirasocio-ekonomike gjatë kalimit të një sistemi më i bazuar te tregu shpesh duhet të përballen me nivele të larta papunësie; me një mospërputhje të madhe mes mundësive të punësimit e tërësisë së aftësive mes qytetarëve; dhe me nevojën për të kryer përshtatje struktur ore, të cilat

kërkojnë financashtesë.

Me burime të pakta dhe me shumë nevoja dhe interesa konkurruese, mbetet përgjegjësi e njësitetë qeverisë vendore që t'u japin përparësi nismave të barazisë gjinore kur përcaktojnë buxhetetvendore. Kjo është në përputhje me parimin e "buxheteve të pavarura" që i akordohen NjQV-ve nëkuadër të procesit të decentralizimit. Përmes këtij

botimi, ne demonstrojmë se një investim përbarazinë gjinore në nivel vendor është një investim për zhvillimin vendor që do të sjellë përfitime për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë - siç do të tregohet, është një investim krahasimisht me kosto të ulët me përfitime afatgjata për komunitetet në përgjithësi.

Është me rëndësi që të mbahet parasysh se edhe me burime të kufizuara qeveritë vendore mund të kryejnë një sërë veprimtarish për t'i bërë proceset qeverisëse më të përgjigjshme ndaj grave dheburrave, vajzave dhe djemve. Për shembull, siç do të shohim, qeveritë vendore mund të punojnëme NBGj-të dhe organizatat e shoqërisë civile për të kryer analiza gjinore për fusha të ndryshme politikash, përfshirë shpërndarjen e buxhetit - për shembull, një analizë e ndikimit të programeve Të asistencës bujqësore mbi gratë dhe burrat specifikisht, aksesin të kujdesit shëndetësor,

apo programe të arsimit fillor. Shpesh, deri në një farë mase, burimet mund të gjenden nëse ekziston përkushtim dhe vetëdija që barazia gjinore do të sjellë përfitime për popullsinë lokale në përgjithësi.

# VLERËSIM I POLITIKAVE GJINORE PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT URBAN, TURIZMIT DHE NDIHMËS EKONOMIKE

Bashkia Vlorë nuk disponon një strategji zhvillimi për qytetin apo strategji për zhvillimin ekonomik të qytetit ku të jenë të shprehura politikat dhe synimet strategjike të Bashkisë për qytetin. Përveç kësaj, ajo nuk disponon as ndonjë plan veprimi për shërbimet në përgjithësi dhe për transportin urban, turizmin dhe ndihmën ekonomike në veçanti. Si rrjedhim, Bashkia Vlorë nuk ka politika të qarta dhe të shkruara për çdo shërbim që ajo ofron, duke përfshirë këtu edhe politika të barazisë gjinore. Nisur nga ky fakt janë shqyrtuar strategjitë kombëtare, në lidhje me shërbimet e përzgjedhura, për të parë se sa politikat kombëtare kanë gjetur zbatim në qeverisjen vendore.

Bashkia Vlorë në strukturën e saj organizative nuk ka një sektor apo drejtori për barazinë gjinore. Ligji nr.9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” përcakton që njësitë e qeverisjes vendore duhet të përcaktojnë një ose disa nëpunës vendorë që merren me çështje të barazisë gjinore. Po sipas këtij ligji organet e qeverisjes vendore kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendor e, të ndara sipas gjinisë, por edhe kjo nuk realizohet për momentin.

Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje, 2011-2015 (SKBGJ-DHBGJ), kërkon një bashkëpunim të ngushtë midis organeve të qeverisjes qendrore dhe



vendore për zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe synimeve strategjike të shprehura në strategji. Koordinimi i punës duhet të bëhet nëpërmjet nëpunësit vendorë për çështjet gjinore në nivel vendor.

Në përgjithësi, shërbimet e ofruara nga Bashkia, kanë marrë vlerësimin e qytetarëve, sidomos grave dhe vajzave, nëpërmjet diskutimeve të hapura dhe forumeve publike në shumë lagje apo rajone të Bashkisë Vlorë. Por, në shumicën e rasteve është vënë re një mungesë eksperience për hartimin e buxhetimit gjinor dhe për trajtimin e çështjeve shqetësuese të grave dhe vajzave nga Bashkia Vlorë.

Takimet e organizuara me komunitetin kanë patur një jehonë edhe në mediat lokale, dhe është për t'u përshëndetur fakti se në takimet e fundit ka patur një pjesëmarrje shumë më të madhe se në fillim, jo vetëm nga qytetarë të thjeshtë por edhe nga përfaqësues të institucioneve publike që i kanë parë këto takime si një mundësi shumë të mirë për të shprehur idetë dhe sugjerimet e tyre për projekt-buxhetin e vitit 2014 për Bashkinë Vlorë.

Të pranishmit në takimet e organizuara me komunitetin kanë përshëndetur takimet e organizuara gjatë të cilave ata kanë patur mundësi të shprehin shqetësimet e tyre në lidhje me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga pushteti vendor. "Takime të tilla na japin mundësi që edhe ne të shprehim mendimet dhe sugjerimet tona si qytetarë. Megjithatë duhet theksuar se duhet të organizohen më shpesh, sidomos nga vetë pushteti vendor, pasi ne jemi ata që votojmë për të zgjedhurit tanë, e duam që ata të vijnë e të qajnë hallet tona bashkë me ne, në çdo lagje, bllok pallatesh apo rrugicë" u shpreh Kastriot Allushi në lagjen 4 Heronjtë.

Megjithatë, qytetarët theksuan se organizime të tilla nga vetë Bashkia për të diskutuar në lidhje me buxhetin apo prioritetet të komunitetit dhe për vlerësimin e shërbimeve organizohen jo shumë shpesh.

Më poshtë vijon analiza e tre sektorëve duke u bazuar në metodologjinë e mësipërme dhe kufizimet e përmendura më lart.

### ***Shërbimi i transportit urban***

Organet e pushtetit vendor janë përgjegjëse për transportin e brendshëm të udhëtarëve brenda juridiksionit të tyre. Bashkitë janë përgjegjëse për transportin qytetës dhe për procesin e lishencimit për transportin ndërqytetës brenda dhe ndërmjet qarqeve.

Bashkitë gjithashtu janë për gjegjëse edhe për shërbimin e udhëtarëve me taksì. Edhe pse transporti publik urban është një funksion i vetë Bashkisë, kjo e fundit duhet të respektojë politikat kombëtare dhe rajonale. Politikat kombëtare për transportin urban të shprehura në Strategjisë Sektoriale të Transportit 2008-

2013 janë tërësisht jo gjinore, madje i gjithë dokumenti ka një mungesë të shprehuri me terma gjinorë. Nga ana tjetër, Bashkia e Vlorës nuk ka politika të qarta e të shkruara për transportin urban. Ky fakt ekufizon analizën vetëm në informacionet dhe të dhënat e mbledhura nga takimet me komunitetin e përfaqësues të Bashkisë dhe nga pyetësorët e realizuar.

Transporti publik në Bashkinë Vlorë përbëhet nga transporti urban i cili realizohet me autobuzë apo edhe me furgona dhe nga transporti taksi. Nuk ofrohet shërbimi me tren, metro apo tramvaj.

Bashkia Vlorë ofron shërbim publik në rreth 70% të territorit të saj. Shërbimi urban nuk ofrohet në lagjet informale në periferi të qytetit, sidomos në ato zona ku infrastruktura është e papërshtatshme për autobuzët ose rruga është shumë e ngushtë. Megjithatë në disa zona informale ku infrastruktura e lejon lëvizjen lirisht të autobuzave, transporti publik funksionon në mënyrë të rregullt.

Gjatë takimeve me komunitetin, ata janë shprehur se e përdorin shpesh transportin publik. Po ashtu nga pyetësorët del se 71% e të pyeturve e përdorin transportin publik,

nga të cilët 80% femra dhe 20% meshkuj. Edhe pse numri i femrave të intervistuar është 3 herë më i lartë se i meshkujve, nga përqindjet e mësipërme, ku raporti është 4:1, rezulton se femrat dominojnë në përdorimin e transportit publik. E thënë ndryshe transporti publik përdoret nga 76% e femrave dhe 56% e meshkujve të intervistuar.

Pjesa më e madhe e femrave që përdorin transportin publik janë të grupmoshës 45-54 vjeç, e pasuar nga grupmosha 18-24 vjeç. E njëjta gjë vërehet edhe tek meshkujt. Gjithashtu, nga të intervistuarit që përdorin transportin publik, 44% e tyre janë të punësuar, 29% të papunë por që kërkojnë punë dhe me 11% studentë. Pak a shumë e njëjta shpërndarje vihet re edhe kur analizohen femrat dhe meshkujt më vete.

Gjithashtu vihet re se brenda grupit të studentëve, 79% e tyre e përdorin transportin publik, përqindje e cila kap edhe shifrën më të lartë midis grupeve sipas statusit të punësimit.

Shërbimi urban në qytetin e Vlorës ofrohet nga dy kompani, njëra publike nën administrimin e Bashkisë, e quajtur “Parku Urban” e cila është SH.A dhe tjetra kompani private, e quajtur “Urban Trans Vlora” e cila është SH.P.K.

Numri i autobuzave të kompanisë nën administrimin e Bashkisë është 10, nga të cilët 6 janë në gjendje pune dhe 4 janë rezervë, ose në gatishmëri. Kompania nën administrimin e Bashkisë subvencionohet nga fondet e Bashkisë me një vlerë vjetore prej 15,000,000 lekë të reja. “Parku Urban” ka të punësuar 87 punonjës nga të cilët, vetëm 5 janë gra dhe vetëm një grua është fatorino.

“Parku Urban i përdor autobuzët e tij në 4 linja që përshkojnë qytetin e Vlorës. Numri i autobuzave të kompanisë private “Urban Trans Vlora” është 14, nga të cilët 10 janë në gjendje pune dhe 4 janë rezervë, ose në gatishmëri. “Urban Trans Vlora”, ka një kontratë 5-vjeçare me Bashkinë Vlorë dhe nuk subvecionohet nga Bashkia. Operatori privat e ka nënshkruar kontratën me Bashkinë Vlorë qysh në vitin 2010 dhe kontrata përfundon në vitin 2015. Operatori privat ka 24 punonjës, dhe vetëm 1 nga këta është grua e cila punon në administratë si ekonomiste.

Megjithëse numri i autobuzëve në qarkullim që përdoren nga të dyja kompanitë për transportin publik është relativisht i kënaqshëm, koordinimi i tyre për zbatimin e orareve dhe ndarjen e linjave të ndryshme lë për të dëshiruar. Edhe qytetarët janë shprehur se edhe pse ka përmirësim të tij ata kanë rezerva për cilësinë e shërbimit të ofruar.

Megjithatë përsëri ka shume zonaperiferike të pambuluara nga shërbimi publik urban për shume arsye. Më kryesorja është mungesa e infrastrukturës në lagjet periferike të populluara me banorë të ardhur nga zonat rurale, dhe shtëpitë e të cilëve janë të palegalizuara ende. Në kontratën e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe kompanisë

private nuk rezulton të ketë asnjë dispozitë mbi detyrimin e respektimit të barazisë gjinore. Në kontratën e nënshkruar vihet re se frekuencat janë shumë të ulëta (çdo 15 min paradite dhe çdo 20 min pas dite) si dhe oraret tepër të kufizuara (nga ora 6.30 deri në orën 21.30), megjithëse Bashkia i lejon kompanisë që në bazë të autonomisë dhe mundësive të saj të vendosë orare më të zgjatura dhe frekuenca më të shpeshta edhe pse në praktike rezultojnë të ndodhi vetëm gjatë periudhës së verës.

Nga pyetësorët del që 57.5% e femrave dhe 76% e meshkujve ndihen të sigurtë gjatë përdorimit të transportit publik. Në ato pak raste që janë përgjigjur përse nuk ndihen të sigurtë arsyet janë për shkak të vjedhjeve dhe “njerëz të rrezikshëm”. Rreth 76% e të intervistuarve janë përgjigjur se nuk i lejojnë fëmijet e tyre të udhëtojnë të vetëm me

transport publik në orët e vona. Edhe këtu përqindja e femrave është më e lartë se e meshkujve duke dalë në rezultatin se femrat janë me skeptike përse i përket sigurisë gjatë përdorimit të transportit publik.

Numri i stacioneve të miratuara nga Bashkia Vlorë është 95. Po ashtu, nga ana tjetër, gati 54% të intervistuarve nuk janë gjithmonë në kohë kur e përdorin transportin public dhe kjo vihet re si te meshkujt edhe te femrat (52% e meshkujve dhe 54% e femrave).

Rreth 82% e të intervistuarve deklarojnë se kanë prituri në stacionin e urbanit. Gjithashtu, oraret e urbanit nuk janë të publikuara në stacione.

Në transportin publik urban operojnë vetëm burra dhe djem, qoftë si shofer

por edhe si fatorino me përjashtim të një gruaje të punësuar si fatorino. Gati 52% e femrave dhe 50% e meshkujve të intervistuar pohojnë se do të ndiheshin më të sigurtë nëse bileta-shitësi ose shoferi do të ishin femra.



### ***Shërbimi Taxi***

Në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë 70 taxi të lishencuara konform rregullave të përcaktuara qartë. Taksitë kane 15 vend-qëndrime të përcaktuara me vendim të Këshillit Bashkiak Vlorë në pik a të ndryshme në qytet. Tarifa për shërbim taksitë është 90 lekë për km, brenda qytetit dhe në rrugë të paasfaltuara, 60 leke/km jashtë qytetit dhe 500

lekë/ora për dispozicion. Pozitiv është fakti që tarifa e shërbimit taxi, vendoset me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të ligjit, por duke marrë për bazë edhe mendimin e shoferëve që punojnë taxi. Shërbimi taxi operon kryesisht i pa organizuar në kompani të cilat kanë në përbërje një numër të caktuar taksish dhe shoferash, si dhe një zyrë apo adresë fikse. Ky shërbim ofrohet kryesisht nga persona privatë, të cilët janë pronarë të një automjeti me 4 vende, dhe pasi marrin lishencën nga Bashkia Vlorë, mund të ushtrojnë profesionin e taksistit, jo vetëm brenda qytetit, por në të gjithë vendin. Operon vetëm një kompani e lishencuar e quajtur “Vlora Taxi” e cila ka në pronësi të saj 4 makina – taxi dhe 4 shoferë. Kjo kompani operon 24 orë dhe ka edhe një zyrë të saj në rrugën

### ***“Transballkanike”.***

Përveç taksive të lishencuara, operojnë edhe shumë taksitë pirate, pa lishencë të cilat konkurojnë në mënyrë të pandershme taksitë e lishencuara. Në shërbimin taxi janë vetëm burra dhe asnjë grua shoferë. Gjatë takimeve me komunitetin është ngritur si pretendim edhe vendosja e taksive “rozë” që nënkupton taksitë të drejtuara nga gratë, gje e cila mund t’u jepte më shumë siguri grave të cilat udhëtojnë në orët e vona.

## **Turizmi**

Zhvillimi ekonomik vendor është një nga funksionet e veta të qeverisjes vendore i cili ndërmjet të tjerash përfshin:

- (i)** përgatitjen e programeve të zhvillimit ekonomik vendor;
- (ii)** ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë;
- (iii)** zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panaire e reklama në vende publike;
- (iv)** organizimi i shërbimeve në m bështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme.

Në këtë funksion përfshihet edhe zhvillimi I turizmit nëse do e shohim nga këndvështrimi i hapjeve të vendeve të punës, duke patur parasysh që bizneset e vogla rregjistrohen pranë njësive të qeverisjes vendore. Por zhvillimi i turizmit lidhet gjithashtu edhe me ruajtjen dhe zhvillimin e vlerav e kulturore dhe historike vendore, organizimin e veprimtarive dhe administrimin e institucioneve përkatëse, që është po ashtu një funksion i vet. Edhe për këtë sektor Bashkia nuk ka politika të qarta dhe të shkruara dhe analiza është bërë duke u mbështetur te strategjitë kombëtare dhe intervistat e pyetësorët.

Një nga prioritetet strategjike të SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 është fuqizimi ekonomik I grave dhe vajzave nëpërmjet adresimit të pabarazive gjinore që çojnë në varfëri dhe promovimit të përfshirjes sociale. Në kuadër të këtij prioriteti synohet që:

- (i)** Të rritet pavarësia ekonomike e grave nëpërmjet shtimit dhe përmirësimit të aksesit në kreditim, programeve dhe strukturave mbështetëse për kujdes dhe mbrojtje shoqërore;
- (ii)** Të vazhdojë të nxitet formimi profesional dhe punësimi I grave dhe vajzave nëpërmjet masave që mbështesin pjesëmarrjen e grave në tregun e punës;
- (iii)** Të nxitet zgjerimi i programeve për punësimin e grave dhe vajzave. Të gjitha këto qëllime dhe synime duhen të arrihen nga një bashkëpunim I ngushtë I qeverisjes qendrore me atë vendore

Në strategjinë sektoriale të turizmit 2007-2013 viret re një m ungesë totale e trajtimit të çështjeve gjinore. Edhe pse strategjia përmban një pjesë se çfarë duhet të bënte pushteti vendor në lidhje me synimet strategjike, ato nuk janë të shprehura në një këndvështrim gjinor.

Pothuajse e njëjta situatë është edhe me strategjinë e zhvillimit të bizneseve dhe investimeve 2007-2013. Megjithëse vihet re që ka patur programe për nxitjen e sipërmarrjes nga gratë, kjo nuk e bën këtë strategji “të ndjeshme gjinore”.

Si rrjedhim, pushteti vendor nuk ka patur referenca të qarta se cilat janë politikat gjinore për t'u përmbushur në nivel vendor, edhe pse kjo nuk e pengonte atë për të hartuar politikat e veta.

Gjithnjë e me shumë turizmi po shndërrohet në furnizuesin kryesor të ekonomisë me të ardhura. Sipas strategjisë aktuale për zhvillimin e turizmit, e cila është aktualisht në fuqi, të ardhurat nga ky sektor në vitin 2012 arritën në 464 milionë dollarë. Në rastin e strategjisë së turizmit parashikimet për pritshmëritë ekonomike kanë rezultuar shumë më të ulëta se ajo çfarë ka ndodhur në realitet.

Turizmi ka demonstruar një potencial të madh për krijimin e vendeve të punës në 20 vitet e fundit në qytetin e Vlorës. Pjesëmarrja e grave në bizneset me fokus turizmin jo vetëm që kontribuon në uljen e varfërisë por edhe përforcon statusin e saj në shoqëri.

Sipas INSTAT, në qarkun e Vlorës në 2011, 26.3% e ndërmarrjeve aktive administrohen nga femrat (26.9% është në shkallë vendi). Vihet re një rritje prej 20% nga 2007 në 2011.

Plani i buxhetit për vitin 2013 për shpenzimet e turizmit nga Bashkia Vlorë llogaritet 15,000,000 lekë. Çelja e sezonit turistik për këtë vit u bë me 11 Maj e u shoqërua me aktivitete të shumta artistike, kulturore e sportive.

Në qytetin e Vlorës operojnë 20 agjensi udhëtimi dhe operatorë turistikë me numër të kufizuar punonjësish. Nivelet e funksioneve në këto kompani janë: agjent udhëtimi, administrator, ekonomist.

Ndërsa për sa i përket Hoteleve ato numërohen rreth 28 në qytetin e Vlorës, sipas statistikave të institucionit të Qarkut Vlorë, me kapacitet akomodimi 600 dhoma.

Sipas një studimi të realizuar nga Zyra e Punës për vitin 2013, në Bashkinë Vlorë rezultojnë këto të dhëna në përqindje në operatorët turistikë, agjensi udhëtimi, restorante dhe hotele të kategorizuar sipas numrit më të lartë të punonjësve, numrit mesatar dhe atij më të ulët. Ajo që vihet re nga të dhënat është fakti se shumica e të

punësuarve me kohë të plotë janë meshkuj kurse femrat rezultojnë më tepër si të punësuarat me kohë të pjesshme, çka do të thotë se të ardhurat e tyre janë të paplota.

Të dhënat pasqyrohen në tabelat e mëposhtme:  
Numri mesatar i punonjësve Meshkuj dhe Femra

### **Mesatarja e Nr të punonjësve me kohë të pjesshme**

Meshkuj Femra

59% 41%

### **Mesatarja e Nr të punonjësve sezonalë**

Meshkuj Femra  
52% 48%

### **Mesatarja e Nr të punonjësve me kohë të plotë**

Meshkuj Femra  
36% 64%

Numri me i lartë i punonjësve Meshkuj dhe Femra

### **Mesatarja e Nr të punonjësve me kohë të pjesshme**

Meshkuj Femra  
50% 50%

### **Mesatarja e Nr. të punonjësve sezonalë**

Meshkuj Femra  
48% 52%

### **Mesatarja e Nr. të punonjësve me kohë të plotë**

Meshkuj Femra  
40% 60%



### **Numri me i ulët i punonjësve Meshkuj dhe Femra**

Meshkuj Femra  
62% 38%

### **Mesatarja e Nr. të punonjësve sezonalë**

Meshkuj Femra  
40% 60%



## Mesatarja e Nr. të punonjësve me kohë të plotë

Meshkuj Femra  
33% 67%

Nga ana tjetër vihet re se pjesa më e madhe e të intervistuarve (87.5%) nuk punojnë në fushën e turizmit. Kështu, 21% e burrave dhe 8% e grave punojnë në këtë fushë.

Gjithashtu vërehet që gratë punojnë kryesisht nëbar-restorante ndërsa burrat në poste më të larta si drejtor, pronar bar - kafe apo biznesmen.

Gratë kryesisht përfitojnë pagesa më të ulta se burrat. Pjesa dërrmuese e 17.63% të hendekut të pagave ndërmjet burrave dhe grave shkaktohet nga shpërblimet e ndryshme të ofruara nga tregu i punës. Kështu, 57% e grave që punojnë në fushën e turizmit pohojnë se pagesa e tyre ka qenë më e ulët se e burrave.

Pyetjes a kanë qenë të përfshirë në ëorkshop/seminare/trajtime të organizuara me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e bizneseve, 82% e femrave janë përgjigjur “asnjëherë” dhe 0% “po gjithmonë”, ndërsa për meshkujt 59% dhe 18% respektivisht.

Një % pothuaj e barabartë prej 30% midis meshkujve dhe femrave deklarojnë se kanë qenë të interesuar për të zhvilluar biznesin përmes kredisë por 48% e femrave dhe 40% e meshkujve kanë hasur vështirësi në marrjen e kredisë. Në 4 raste nga 28 femra identifikohet se kërkesat e larta dhe procedurat janë shkak i vështirësive për marrjen e kredisë. Po ashtu evidentohet edhe mungesa e pronës dhe të ardhura të pamjaftueshme për të mbuluar kredinë. Shërbimi i vetëm i kreditimit i ofruar nga Bashkia në bashkëpunim me bankat janë kreditë e buta për të pastrehët dhe sipas Bashkisë nuk ka asnjë mundësi tjetër kreditimi për zhvillimin e bizneseve.

## Shërbimi i Ndhmës Ekonomike

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka qenë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike për periudhën 2011-2013. Ajo ka qenë autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të legjislacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, si dhe për kontrollin e zbatimit e tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat.

Shërbimi Social Shtetëror, që është një institucion publik nën varësinë e MPÇSSHB, përgjigjet për zbatimin e politikave të Ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në fushën e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.



Ndërsa Këshilli i Bashkisë ose Komunës miraton fondin dhe numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike; harton planin për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, bazuar në burimet, nevojat dhe përparësitë vendore; miraton dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit në bazë të vlerësimit të nevojave e përparësive vendore; merr vendime për personat, familjet, llojet e shërbimeve shoqërore që do të ofrohen bazuar në:

a) vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve, të kryera nga administratori shoqëror dhe

b) mundësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve;

vendos, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të drejtën dhe masën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjen, si dhe ofrimin e përfitimeve të veçanta, të parashikuara me ligj; miraton programet për kushtëzimin e ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet. Kriteret për kushtëzimin e ndihmës me punë e shërbime

në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Ndihma ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë dhe e kushtëzuar, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë:**

**(I)** Familjet në nevojë;

**(II)** Jetimët, të cilët nuk janë në institucione;

**(III)** Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

**(IV)** Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre;

**(V)** Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

**Ndihma ekonomike është e plotë ose e pjesshme. Atë e përfitojnë të plotë familjet ose individët, që nuk kanë të ardhura nga:**

**(i)** eprimtaria ekonomike;

**(ii)** programet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore ose ndonjë sistem tjetër i mbrojtjes shoqërore;

**(iii)** pjesëtarët e familjes që janë në emigracion.

## Ndihma ekonomike është e pjesshme kur familja pretenduese ka të ardhura të pamjaftueshme nga:

- (i) toka;
- (ii) bagëtia, shpendët, bletët, vreshtaria e kopshtaria;
- (iii) pensionet dhe të ardhura të tjera.



Vendimi merret në bazë të kërkesës së bërë nga kryetari i familjes ose secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë, tek Administratori Social i cili ndodhet në Rajonin përkatës ku ka adresën familja. Kërkesa nënshkruhet edhe nga të gjithë anëtarët madhorë të saj, duke deklaruar edhe personin madhor që do të administrojë paratë.

Pas kërkesës së depozituar në Rajon, lajmërohet zyra e Shërbimit social të Bashkisë, e cila bën verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes dhe pasi merr përgjigje, hartohet projekt–vendimi i cili miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Ligji parashikon burrin si kryetar të familjes dhe gruaja mund të aplikojë vetëm kur është në proces zgjidhjeje martesë, vajzë nënë ose e ve. Kjo përbën vështirësi për gratë që I kanë bashkëshortët e tyre në emigrim dhe që ligji i përjashton nga ndihma ekonomike edhe pse bashkëshorti nuk i dër gon para familjes. E vetmja mënyrë për këto gra është të divorcohen dhe të bëhen kryetare të familjes. Një tjetër vështirësi haset në rastin kur burri si kryefamiljar përfiton ndihmën ekonomike dhe abuzon me administrimin e saj.

Megjithatë punonjës të shërbimit social në bashki shprehen se për rast të identifikuar ata mundohen që përfitimin t’ua japin grave.

Ndihmën ekonomike në Bashkinë Vlorë, sipas drejtores së Shërbimit Social Shtetëror deri në muajin Dhjetor 2013 e përfitojnë 926 familje, nga të cilat 350 janë kryefamiljare gra të veja, të divorcuara apo vajza nëna. Numri i familjeve që përfitojnë ndihme ekonomike ka ardhur duke u shtuar, e megjithatë përsëri ka akoma kërkesa nga familje

në nevojë për të përfituar ndihmë ekonomike, por për arsye të fondeve jo të

mjaftueshme, nuk përfitojnë nga skema e ndihmë ekonomike të qeverisë. Financimi i programeve të ndihmës ekonomike përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe buxhetet e qeverisjes vendore. Këshilli i bashkisë ose komunës ka të drejtë të miratojë kritere specifike për të dhënë ndihmë ekonomike ose për të ofruar shërbime të përkujdesit, me fondet e buxhetit vendor, dhe deri në 3 për qind të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për familjet me shumë pjesëtarë apo familjet në nevojë.

Në këtë kuadër, edhe Bashkia e Vlorës ka përdorur një pjesë të fondeve të veta për të dhënë ndihmë ekonomike.

Gjithashtu Këshilli, me vendim të posaçëm, për familjet që nuk i plotësojnë të gjitha kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike dhe për zbutjen e varferisë në qytet në bazë të ligjit Nr.8652 datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 72, pika 4, paragrafi 1, gërma c, VKM Nr.763, datë 29.11.1995, pika 2,

germa c, "Përkriteret e përdorimit të të ardhurave të Pushtetit Lokal", si dhe VKM Nr.787, datë 14.12.2005, merr vendim për të futur në skemën e ndihmës ekonomike familje të tjera që nuk përkrahen me ndihmë nga fondet e Ministrisë së Punës, Mirëqënies Sociale dhe Shanseve të barabarta.

Ndihma ekonomike pasi përfitohet nga familja, tërhiqet pranë bankave të nivelit të dytë që operojnë në qytet në bazë të marrëveshjes së arritur qysh më parë midis institucionit të Bashkisë dhe bankës përkatëse. Zakonisht të drejtën për të tërhequr të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike e kanë kryefamiljarët burra, duke privuar gratë nga

përfitimi i të ardhurave. Kjo mbështetet edhe nga rezultatet e pyetësorëve ku 63% e atyre që marrin ndihmë ekonomike deklarojnë se ndihmën e përfiton kryefamiljari.



Vlera financiare e ndihmës ekonomike deri në vitin 2013, sipas drejtores së Shërbimit Social Shtetëror është 2,600 lekë për kryefamiljarin dhe 600 lekë për

personat në moshë pune e 700 lekë për personat nën moshë pune. Kështu, një familje prej 4 personash përfiton rreth 4,200 lekë ndihmë sociale në muaj. Është pranuar gjerësisht nga shumë grupe interesi, përfitues të ndihmës ekonomike, këshilltarë dhe zyrtarë local, që vlera e ndihmës ekonomike është shumë e vogël dhe nuk është indeksuar me përqindjen e inflacionit në vite. Kjo konstatohet edhe nga 75% e femrave kryefamiljare të intervistuar dhe që marrin ndihmë ekonomike të cilat pohojnë se ndihma nuk është e mjaftueshme për nevojat tyre jetike. Gjithashtu shumica e përfituar nga ndihma ekonomike është shumë e vogël se minimumi jetik prej 12,000 lekë në muaj, gjë që flet qartë për pamjaftueshmërinë e saj për përmbushjen e nevojave jetike. Përveç pamjaftueshmërisë së ndihmës ekonomike, një shqetësim tjetër i ngritur nga komuniteti është marrja me vonësë e saj. 57% e të pyeturve deklarojnë se e marrin me vonësë ndihmën ekonomike dhe vonesat shkojnë nga 1 javë deri në 3 muaj. Ndërkohë, sipas ligjit ndihma ekonomike duhet shpërndarë një herë në muaj me vendim të Këshillit të Bashkisë. Nga takimet gratë që përfitojnë nga ndihma sociale shprehën nevojën për t'u përkratur nga Bashkia edhe me shërbime të tjera sociale si psh: pagimi i detyrimeve shtetërore për çerdhen dhe kopshtin e fëmijëve, pagim i i faturave të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm, rimbursimi i librave të shkollës.

### ***Në strategjinë e mbrojtjes sociale 2007-2013 përshkruhen këto politika për ndihmën ekonomike:***

- Përdorimi i informacionit për: vlerësimin e varfërisë; identifikimi i numrit të familjeve të varfra dhe fondet e duhura për bllok grantet e ndihmës ekonomike për çdo njësi të pushtetit local;
- Rritja e masës së mbulimit të nevojave të familjeve të varfra me përfitime;
- Përmirësimi i vlerësimit të familjeve aplikante;
- Kushtëzimi i shpërndarjes së NE me pjesëmarrjen në punët në komunitet;
- Kushtëzimi i shpërndarjes së NE me pagesën e energjisë elektrike;
- Asistencë dhe mbështetje e romeve për aplikimin dhe përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet e varfra.

Ndihma ekonomike është një funksion i deleguar pushtetit vendor nga ai qendror dhe si rrjedhim pushteti vendor duhet të ndjekë dhe të zbatojë politikat kombëtare për këtë shërbim. Duket qartë që politikat e mësipërme janë neutrale nga pikëpamja gjinore.

Edhe pse në strategji ekziston një pjesë për gratën seksionin "Mbështetja e

# VLERËSIM I BUXHETEVE VENDORE PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT URBAN, TURIZMIT DHE NDIHMËS EKONOMIKE

Buxheti i Bashkisë Vlorë përfshin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për realizimin e funksioneve në zbatim të politikave kombëtare dhe rajonale.

## **Të ardhurat.**

Pjesën kryesore të të ardhurave ( rreth 54-55%) e zënë të ardhurat nga taksat siç janë taksat mbi biznesin e vogël, ndërtimet e reja, tabelat dhe reklamat etj. Vendin e dytë (29-30%) e zënë të ardhurat e tjera si transfertat e pakushtëzuar, kredi dhe hua, donacione etj. Rreth 14% zënë të ardhurat nga tarifatat e ndryshme dhe një përqindje shumë të vogël zënë të ardhurat nga shitja e pronës, dhënia me qera etj.

Nga ana e Bashkisë paraqitet si çështje me rendësi kritike në fushën e administrimit të të ardhurave administrimi i taksave dhe i tarifave të paguara nga qytetarët.

Në relacion nuk paraqitet ndonjë politikë apo nismë e veçantë për lehtësimin në drejtim të lehtësimit të taksave siç është p.sh taksa e biznesit të vogël për bizneset që drejtohen nga gratë.

Taksa e Biznesit të Vogël është planifikuar të rritet mesatarisht 2% në vitin 2013 dhe mesatarisht 4% për vitet në vijim. Në rastin e vjeljes së taksës, është supozuar që vlera do të rritet me një dinamikë prej 4% në çdo vit të parashikimit.

Për sa i takon të ardhurave nga turizmi është parashikuar që të ardhurat do të shtohen 3% në vitin 2013 dhe me 5% e 6% gjatë periudhës tjetër të parashikimit, si pasojë e zhvillimit të tregut dhe shtimit të numrit të strukturave hoteliere dhe vizitorëve në qytet.



### **Shpenzimet**

Shpenzimet në buxhetin e Bashkisë Vlorë janë planifikuar mbi bazën e funksioneve që lidhen me shërbime të tilla si pastrim gjelbërim, ujësjellës kanalizime, zhvillimin e turizmit dhe transportit publik, programet kulturore, kujdesi social, arsimi dhe sporte si dhe shërbime të tjera publike.

Nga rishikimi i buxhetit afatmesëm për periudhën 2013-2015 vërehet që pjesën më të madhe të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve të Bashkisë e zënë shpenzimet që lidhen me shërbimet e ujësjellës kanalizime, pastrim gjelbërim, arsim, sport.

Shpenzimet për transportin publik zënë 1% të shpenzimeve totale dhe ato për kujdesin social 2% të tyre. Shpenzimet për zhvillimin e turizmit zënë 5% të shpenzimeve totale, duke qënë në një nivel më të lartë së shpenzimet për transportin publik dhe ato për kujdesin social dhe shërbimet sociale.

### **Kujdesi Social dhe Shërbimet Sociale**

Kujdesi social është funksion i deleguar që financohet tërësisht nga granti i caktuar që vjen nga buxheti i Qeverisë Qëndrore. Ndhimja ekonomike dhe ndihma për personat me aftësi të kufizuar përfshihet në buxhetin e Bashkisë, në të cilën përfshihen personat që nuk plotësojnë kriteret e ligjit për ndihmen ekonomike (familjet në nevojë me vendim të veçantë të Këshillit të Bashkisë). Në bazë të relacionit të Bashkisë supozohet që numri I përfituesve të ndihmës ekonomike do të ulet në vitet e ardhshme, por do të shtohet ndërkohë vlera e përfitimit për familje. Për këtë arsye është planifikuar që shpenzimet për këtë

zë do të rriten me një dinamikë vjetore prej 5% gjatë viteve 2013-2015.

Relacioni i buxhetit nuk jep ndonjë informacion të veçantë mbi përfituesit apo masën e ndihmës ekonomike në përgjithsi dhe veçanërisht të dhëna më bazë gjinore, gjë që vështirëson edhe analizën për një buxhetim gjinor.

### **Transporti Urban**

Transporti Urban është funksion i vet i Bashkisë i financuar nga të ardhurat e veta, për diferencëçmimi (subvencion). Është planifikuar që shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes do të rriten me një dinamikë vjetore prej 4% për tre vitet 2013-2015.

Relacioni nuk përmban ndonjë të dhënë më konkrete për të ndihmuar analizën në përgjithësi dhe atë me bazë gjinore në veçanti.

### **Turizmi**

Megjithëse Vlora është një qytet që ofron një potencial të madh turistik shpenzimet për turizmin nga ana e Bashkisë planifikohen të pandryshuara për periudhën afatmesme 2013-2015. Në relacionin e projekt-buxhetit nuk jepet ndonjë informacion nëse se do të ketë politika të veçanta për zhvillimin e turizmit mbështetur edhe në strategjinë

kombëtare për turizmin dhe nëse këto politika do të mbështeten nga buxheti vendor, megjithëse nga analiza e të ardhurave ky sektor është parashikuar me rritje.

Vërehet se Bashkia nuk organizon trajnime / seminare / ëorkshope mbi barazinë gjinore dhe buxhetimin gjinor, pasi, gati 76% e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht pyetjes mbi trajnimet për barazinë gjinore dhe 86% për buxhetimin gjinor. Përveç kësaj 62% e të intervistuarve janë përgjigjur se nuk kanë patur informacion mbi takimet e

zhvilluara nga Bashkia për diskutimin e draft buxhetit. Nga ana tjetër vihet re që edhe qytetarët nuk i drejtohen Bashkisë për realizimin e nevojave të tyre. 60% e të intervistuarve e konfirmojnë këtë fakt. Në rast se do analizonim sipas gjinisë, vetem 52% e burrave dhe 36% e grave i janë drejtuar Bashkisë për zgjidhjen e nevojave.

Brenda këtij grupi vetëm ½ se burrave dhe 1/3 se grave Bashkia i ka dhënë zgjidhje apo ka treguar vullnetin e nevojshëm për t'i ndihmuar apo e thënë ndryshe 39% të rasteve në total. Një pjesë e mirë e tyre deklarojnë se i janë drejtuar Bashkisë në formë zyrtare dhe me shkrim.

### **GJETJET E STUDIMIT**

Rritja e bashkëpunimit midis autoriteteve qendrore dhe lokale do të kontribuojë në krijimin dhe zbatimin e politikave në përputhje me kushtet lokale. Nevojitet



koordinim dhe bashkëpunim i këtyre politikave në mënyrë që do të mundësojë përputhje të politikave të pergjithshme dhe nevojave të komuniteteve lokale. Pushteti lokal ka një njohje relativisht të mirë të prioriteteve të qytetarëve. Kjo shihet nga mënyra sesi ata i krijojnë programet lokale, dhe në procesin e zbatimit të tyre. Bashkia punon në mënyrë transparente, dhe në koordinim, sidomos me institucionet që janë nën kompetencën e saj. Kështu procesi i hartimit të politikave bazohet në nevojat reale të komunitetit lokal.

Edhe pse Bashkia po bën përpjekje që në mënyra të ndryshme të shpërndajë mjetet për realizimin e tyre (sidomos përmes aktiviteteve vetëfinancuese dhe sigurimin e donacioneve) përsëri, ajo në masë të madhe akoma mbështetet në mjetet që sigurohen nga buxheti i shtetit.

Nevojitet përforsim i kapaciteteve të pushtetit lokal në gjetjen e qasjeve të reja për realizimin e aktiviteteve të tyre. Në këtë drejtim, pushteti lokal duhet t'ishfrytëzojë mundësitë si për marrjen e mjeteve financiare shitesë (për shembull, sigurimi i donacioneve ose formimi i partneriteteve privato-publike), poashtuedhe në gjetjen e mënyrave alternative për plotësimin e nevojave të qytetarëve (përshembull, transferimi i nje pjese te kompetencave nga sfera sociale, organizatavejoqeveritare lokale).

Proçesi i krijimit të politikave efikase dhe efektive duhet të bazohet në analiza,që do të paraqisnin gjendjen momentale, dhe që do të jepnin udhëzime për tëardhmen. Në këtë mënyrë komuna do të mund të identifikojë tendencat dhe nevojatspecifike të grupeve të ndryshme në komunitetin lokal. Përfshirja e perspektivës gjinore në segmentet kryesore të shoqërisë paraqetstrategji të rëndësishme për zvogëlim të pabarazive që ekzistojnë

mes grave dheburrave në shoqëri. Kjo do të thotë që të gjitha proçeset në shoqëri – politike,ekonomike dhe sociale – duhet të zhvillohen, të zbatohen dhe të vlerësohen, dukemarrë parasysh ndikimin që ato kanë mbi barazinë gjinore. Buxheti duhet të hartohet në mënyrë të tillë që shpenzimet dhe vendimet buxhetore të jenë në pajtim me nevojat, që përfshijnë ato dhe që janë në pajtim me analizat e gjendjeve dhe të prioriteteve të komunitetit. Duke patur parasysh faktin që programet e Sektorëve të ndryshëm miratohen dhe ndiqen përmes komisioneve përkatëse, është e nevojshme që të kemi një shpërndarje më të mirë të fondeve për t'i ardhur në ndihmë grave dhe vajzave në sektorë të ndryshëm sipas mundësive aktuale që ka Bashkia Vlorë. Ky buxhet mund të strukturohet sipas programit, që do të mundësojë vëzhgim buxhetor të futjes në përdorim të programeve, duke siguruar njëkohësisht transparencë dhe efektshmëri më të madhe në shpenzimin e fondeve të siguruara.

Proçesi i decentralizimit është instrument për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë miratimit të vendimeve, por gjithashtu nuk është garanci që nevojat e të gjithë qytetarëve do të jenë të shprehura në politikat e nivelit lokal. Koncepti i



buxhetimit gjinor, si strategji e orientuar drejt politikave ekonomike, me fokus në buxhet, do të rrisë nivelin e transparencës, si dhe do të përmirësojë politikat ekonomike në drejtim të plotësimit të nevojave të ndryshme të grave dhe burrave në komunë.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia mbi buxhetin vjetor 2012 dhe planifikimin 3-vjeçar 2013 – 2015 të buxhetit rezulton se janë planifikuar rritje të taksave të biznesit të vogël, rritje të shpenzimeve për ndihmën ekonomike, rritje të shpenzimeve për transportin urban, por pa marrë parasysh shpërndarjen gjinore të shërbimeve.

Ndërkohë që shpenzimet e lidhura me turizmin, parashikohen të pandryshuara për një periudhë tre vjecare. Nga rezultati i këtyre të dhënave, del se jo vetëm që Bashkia nuk parashikon analizë gjinore, por nuk ka asnjë informacion të vecantë mbi përfituesit e shërbimeve dhe masën e përfitimit. Realizimi i rekomandimeve të dala nga projekti, si në fushën e shërbimit social, të turizmit dhe të transportit publik, duhet të realizohet nga Bashkia në bashkëpunim me organizatat jo-fitimprurëse. Megjithatë, disa rekomandime si ai i realizimit të fushatave të sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit mbi konceptin e buxhetimit gjinor, pilotimi i shërbimit gjinor në sektorët e shërbimit social, nxitja e bizneseve turistike që drejtohen nga vajzat dhe gratë, si dhe ndryshimi i dispozitave të kontratave të lidhura për transportin publik, me qëllim, rritjen e punësimit të grave në këtë sektor, mund të realizohen përmes dëshirës së mirë të Bashkisë dhe strukturave të saj. Problematika kryesore e dalë nga takimet rezulton të jetë ajo e lidhur me përfitimin e shërbimit social, si dhe ngritjen e kapacitetit të grave dhe vajzave, kërkesa këto që mund të realizohen përmes, bashkëpunimit midis Bashkisë dhe Zyrës së Punës si dhe përmes një administrimi më të mirë që favorizon gratë dhe vajzat në shërbimin social.

# REKOMANDIME

## *Rekomandime të përgjithshme për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator:*

- Realizimi i fushatave të sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit nga njësia vendore në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, për të familjarizuar qytetarët, grupet e interesit dhe OSHC-të me konceptin e buxhetimit gjinator si dhe organizimi i trajnimeve/seminareve/ëorkshopeve mbi çështje të barazisë gjinore dhe buxhetimit gjinator, me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve;
- Rritja e angazhimit të Bashkisë në bashkëpunim me institucione të tjera dhe OSHC-të për të organizuar takime dhe konsultime të hapura me publikun për diskutimin e draft buxhetit ku te sigurohet pjesëmarrje si për burrat e djemtë ashtu dhe për gratë e vajzat;
- Të fillojë pilotimi i buxhetimit gjinator për sektorët e shërbimit social, transportit publik dhe turizmit sipas stadeve të përcaktuara në raport;
- Të krijohet një data base me të dhëna të pa përpunuara (meshkuj / femra) të paktën për sektorët që do të pilotohet buxhetimi gjinator;
- Krijimi i një Qendre Psiko – Sociale në ndihmë të grave dhe vajzave në nevojë;
- Rritje të ndihmës ekonomike duke gjetur forma stimuluese edhe me punësime par time (Në sektorin e gjelbërimit, menaxhimit të mbetjeve..etj në menyrë që të shmangët parazitizmi;
- Punësimi i grave dhe vajzave në sektorin artizanor apo ushqimor (përpunime frutash, perime apo prodhime deti si dhe krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për të tregëtuar produktet gjat sezonit në menyre të organizuar dhe të kulturuar;
- Nxitja e një agjencie shërbimit nën kujdesin e Bashkisë, për punësimin e grave dhe vajzave të specializuara për shërbime në familje si pastrim shtëpie, bebisiter etj.

## ***Rekomandime në fushën e Asistencës Sociale***

- Bashkia, me autoritetin e saj, nëpërmjet Këshillit Bashkiak dhe administratës, të mundësojë që punonjësi i shërbimit social, të vendosë emrin e të dy bashkëshortëve (burri dhe gruaja), jo vetëm kryefamiljarit në tërheqjen e asistencës sociale.
- Të ketë negociata midis Bashkisë me institucionet e qeverisjes qendrore dhe donatorë të mundshëm me qëllim që familjet të cilat janë në skemën e ndihmës sociale të përfitojnë kushte lehtësuesë si psh: libra, ushqime, medikamente, veshmbathjeve falas, duke përfshirë edhe një pjesë të fondeve të Bashkisë.
- Bashkia në bashkëpunim me organizat e shoqërisë civile dhe donatorë të krijojë kushte të përshtatshme për të mundësuar integrimin e grave dhe vajzave invalide.

## ***Rekomandime në fushën e Turizmit***

- Nxitja e bizneseve turistike që drejtohen/zotërohen nga vajzat dhe gratë duke iu krijuar atyre lehtësi fiskale nëpërmjet reduktimit të taksave vendore.
- Të mundësojë krijimin e kushteve lehtësuese dhe favorizuese (lehtësi fiskale; çmime fituese për inkurajimin e bizneseve turistike që kanë staf gra, konkurse, kompeticione të ndryshme, etj.) për punësimin e grave dhe vajzave në fushën e turizmit si Agjente turistike, Kamariere, Bariste, DJ, Hostes, etj.
- Bashkia të krijojë politika nxitëse dhe lehtësi për të mundësuar organizimin e panairove sezonale me produkte tradicionale të zonës të përgatitura nga grate dhe vajzat ose prodhime artizanale duke rritur në këtë mënyrë vizibilitetin e këtyre produkteve për turistët vendas dhe të huaj.
- Të nxisë organizimin e aktiviteteve kulturore gjatë sezonit të verës duke promovuar pjesëmarrjen e talenteve vajza.

## ***Rekomandime për Transportin Publik***

- Bashkia të bëjë të mundur pajisjen e stacioneve të autobusëve me oraret e mjeteve të transportit publik dhe itinerarin që përshkojnë linjat e ndryshme duke i siguruar gratë për kthimin nga puna në orët e vona dhe për mirëmenaxhimin e kohës së tyre.
- Duhet të nxitet punësimi i biletashitëseve dhe fatorinove gra si dhe të sigurohet barazia gjinore në stafet e kompanive të transportit duke i parashtruar kontratën nga ana e Bashkisë sh.a. fituesetë transportit publik duke rritur në këtë mënyrë praninë e grave në pozicione pune “pronë” të burrave
- Duhet të përmirësohet ofrimi i shërbimit të transportit publik në lidhje me

vonesat e mjeteve të transportit dhe shtimin e linjave që nuk mbulohen prej tij, pasi sidomos në zonat informale gratë dhe vajzat mbeten të izoluar në pamundësi të një mjeti tjetër lëvizës (burrat dhe djemtë mund të gjejnë mënyra alternative si psh. Automjetet e rastit të të njohurve, biçikleta, etj.).

- Të zgjatet orari i linjave të transportit publik veçanërisht në unazën e qytetit duke iu dhënë mundësi për punë në turnin e dytë grave dhe vajzave që e kanë të pamundur të kthehen në këmbë.

### ***Raste Suksesi;***

Shembujt në Mbretërinë e Bashkuar kanë treguar se kudo ku buxhetimi gjinor është përhapur dhe është mbështetur nga politika, administrata dhe shoqëria civile implementimi i tij ka qënë i suksesshëm. Përdorimi i buxhetimit gjinor në Mbretërinë e Bashkuar nuk është një proces i pastër administrativ. Vullneti politik i qeverisë por edhe vullneti i shoqërisë civile ka qënë një parakusht i rëndësishëm. Konsiderohet me një rëndësi të madhe impenjimi i njerëzve të përkushtuar në shoqërinë civile të cilët e mbajnë procesin gjallë për një kohë të gjatë. Nga pikëpamja administrative ka patur një bashkëpunim të rëndësishëm midis Departamentit të Financës dhe Departamentit të Barazisë Gjinore.

Përvojat në Austri dhe Zvicër kanë treguar se të dhënat e diferencuara gjinore përbëjnë bazën për orientimin e fondeve publike kundrejt grupeve në nevojë. Nëse është e mundur që kjo analizë të përfshihet në procesin e buxhetimit gjinor, kjo qasje do të pranohej edhe në sektorin administrativ.

Shembulli i qytetit të Berlinit ilustron në mënyrë të qartë rolin kryesor që përfaqësimi i njerëzve luan në procesin e buxhetimit gjinor. Aktorë të rëndësishëm në qytetin e Berlinit vlerësojnë rolin e buxhetimit gjinor në transparencën dhe modernizimin e proçeseve në menaxhimin e buxhetit.



